

**STATUTI I SHOQËRISË  
“F & B DISTRIBUZIONE SRL”**

**EMËRTIMI – QËLLIMI – SELIA – KOHËZGJATJA**

**Neni 1**

Themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“F & B DISTRIBUZIONE SRL”**.

**Neni 2**

Selia e shoqërisë ndodhet në Komunën Anzola dell'Emilia (BO) në adresën që rezulton te regjistrimi i posaçëm kryer pranë Regjistrat Tregtar.

Organi Administrativ ka të drejtën të hapë ose mbyllë kudo njësi lokale operative (për shembull degë, filiale ose zyra administrative pa përfaqësim të qëndrueshëm) dhe të transferojë selinë e shoqërisë në Komunë. Ndërsa u takon ortakëve që të vendosin në lidhje me hapjen e selive dytësore ose transferimin e selisë në një Komunë tjetër.

**Neni 3**

**Shoqëria ka si objekt veprimtaritë e mëposhtme:**

- tregtimin në çdo lloj forme, në Itali dhe jashtë saj, të lëndëve të para, mallrave, makinerive dhe impianteve të çdo lloji, si në fushën e ushqimeve dhe në fusha të tjera, në sektorin shëndetësor, tekstil në pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive dhe gjithë produkteve që kanë lidhje me sa më sipër;
- aktivitetin si për llogari të vet dhe për llogari të tretëve të therjes së mishit, punimin, trajimin, pastrimin nga kockat, stazhonimin, ambalazhimin, konservimin, edhe nëpermjet ngrirjes, ndarjen, lidhjen, grumbullimin dhe veçimin, presimin, ambalazhimin, konfekcionimin në boshillëk dhe dërgimin, marrjen dhe dorëzimin, dërgimin në vend, seleksionimin e produkteve ushqimore në përgjithësi dhe derivatëve të tyre dhe në veçanti të mishrave të çdo lloji si të freskëta, të frigoriferit apo të ngrira, të produkteve të mishit dhe të produkteve të ngjashme me to, të derivatëve të mishit dhe nënprodukteve përkatëse në përgjithësi të proshutave, sallamrave, mishit të përpunuuar, gici, të përzier, viçi, produkteve të peshkut dhe ushqime në përgjithësi;
- prodhim dhe paketim mishi të freskët, të kripur, të përpunuuar dhe prebatur në përgjithësi, produkte mishi ose me bazë mishi të gatuar, gjak i gatuar, plënci, gjuhë të marinuara, mishi të egër, vezë, kërmij;

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata

**ENGLANTINA PATA**  
Traduttore Giurato/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 69507  
[eglapata@gmail.com](mailto:eglapata@gmail.com)

- punim dhe transformim qumështi, të derivatëve të tij dhe gjithë aktivitete e përdorimit të derivatëve dhe përpunimet e qumështit, bulmetit, impante dhe menaxhim industrial në sektorin ushqimor me prodhim djathërash të shkrirë dhe produktesh ushqimore;
- shërbimi i shpërndarjes së mishit për llogari të të tretëve;
- prodhimi, ambalazhimi i produkteve për furrë, të freskëta ose tëngrira;
- Prodhimi i ushqimeve të freskëta dhe të konfekcionuara paraprakisht dhe i produkteve të gastronomisë, të konfekcionuara dhe tëngrira;
- Aktiviteti i produkteve të pasticerisë, të freskëta, të thata dhe të kripura;
- Menaxhimi i aktiviteteve publike dhe prodhimi i vakteve ushqimore për shoqëritë, të paketuara dhe të freskëta;
- Menaxhimi i self-service;
- Prodhimi dhe shndërrimi agro-ushqimor, me paketimin dhe tregtimin përkates;
- Aktiviteti i franchising;
- Autotransporti i mallrave për llogari të vet ose për llogari të të tretëve;
- Aktiviteti i depozitimit të produkteve ushqimore në përgjithësi dhe të derivatëve të tyre
- Aktiviteti i organizmit dhe mbajtjes së kurseve të trajnimit në sektorë që kanë të bëjnë me aktivitetin e shoqërisë;
- Aktivitet konsulencë dhe asistence, tregimi me shumicë, pakicë dhe on-line në sektorin ushqimor dhe në sektor të ngjashëm
- Aktivitet blerjeje, shitjeje, dhënje me qera, marrjeje me qera, të pasurive të luajtshme të regjistruara, të pajisjeve dhe makinerive;
- Aktiviteti i ofrimit të ushqimeve dhe pijeve nëpërmjet distributorëve automatikë dhe shitje me shumicë e ushqimeve, pijeve, alkolike dhe superalkolike dhe ushqimeve për kafshë;
- Kërkime tregu në sektorët e mësipërm;
- Blerja, shitja, shkëmbimi, qeraja edhe financiare, dhënia me qera dhe menaxhimi në përgjithësi, i të mirave të paluajtshme, të luajtshme, dhe shoqërive të çdo lloji;
- Blerja, shitja ose shfrytëzimi ekonomik, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë në çdo lloj forme, i markave, patentave, licencave dhe procedimeve të prodhimit;
- Realizimi i kërkimeve teknologjike për inovacionin e produkteve dhe proceseve prodhuese dhe kurimin e zhvillimit të produkteve të reja që mund të tregtohen me markën e dedikuar; të bëjë kërkime tregu dhe përpunime planesh strategjike marketingu. Në kryerjen e këtyre aktivitetave, aktivitetet profesionale të nevojshme do të kryhen, sipas detyrës që iu është caktuar drejtpërsëdrejti nga shoqëria, nga profesionistë të specializuar, siç përcaktohet nga ligji i datës 23 nëntor 1939 nr. 1815.

Përashtohen shprehimisht aktivitetet e ndaluara dhe/ose rezervuar nga legjislacioni në fuqi. Shoqëria mund të përfundojë dhe nënshkruajë kontrata tenderimi dhe nëntenderimi me ente publike dhe private, organizma dhe shoqëri kombëtare dhe ndërkombëtare publike dhe private në lidhje me aktivitetet e sipërtreguara.

Shoqëria mund të kryejë gjithsesi gjithë veprimet tregtare, industriale, financiare, në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, përfaqësimi dhe komisioni, eksporti dhe importi të nevojshme dhe të lidhura gjithsesi me përbushjen e objektit kryesor të shoqërisë dhe të marrë pjesëmarrje në fitime dhe pjesëmarrje në shoqëri të tjera italiane ose të huaja me qëllimin e vetëm të investimit të qëndrueshëm dhe jo profesionalisht me qëllimin e pozicionimit kundrejt publikut, të japë financime në çdo formë jo profesionalisht dhe as kundrejt publikut por në mënyrë të rastësishme dhe në kuadrin ekskluziv të shoqërive të grupit të vet, të kërkojë kredi

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata

<b>ENGLANTINA PATA</b>
Traduttore/Giurato/Përkthyes Zyrtar
Cel: +355 (0) 68 29 69507
eglapata@gmail.com

fondesh, për ndërtim dhe hipotekore, dhe të japë dorëzani dhe garanci në përgjithësi edhe për obligacione të të tretëve.

#### Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë është deri në 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2035 (dymijëetridhjetëepesë) dhe mund të zgjatet me vendim të Asamblesë.

### KAPITALI I SHOQËRISË – FINANCIMET E ORTAKËVE

#### Neni 5

Kapitali i Shoqërisë është 40.000,00 euro (dyzetmijë presje zero zero).

Kapitali mund të rritet me vendim të asamblesë së ortakëve, që duhet zbatuar me mazhorancat e parashikuara për ndryshimin e këtij Statuti, pra në zbatim të vendimit të Bordit Drejtues ose të Administratorëve në zbatim të nenit vijues 36.

I takon Bordit Drejtues ose Administratorëve e drejta e rritjes së kapitalit, u takon jo më shumë se një herë në çdo vit ushtrimor të shoqërisë, pa përjashtuar gjithsesi të drejtën e ortakëve për të nënshkruar rritjen në përpjesëtim me pjesëmarrjet që ata zoterojnë dhe t'u caktojnë ortakëve pjesëmarrje të përcaktuara në masë që nuk është në përmjesëtim me kontributet.


Në rast rritjeje të kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kontributeve të reja u takon ortakëve e drejta që të nënshkruajnë në përpjesëtim me pjesëmarrjet që ata zoterojnë.

U jepet ortakëve e drejta për të parashikuar shprehimisht në vendimin e rritjes, që rritja mund të bëhet edhe nëpërmjet ofertës së kuotave që u jepen si të reja të tretëve me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 2482-ter kodi civil.

Mund të jepen, me lirim të rritjes së pagesës së kapitalit, gjithë elementet e aktivit që mund të vlerësohen ekonomikisht, duke përfshirë kryerjen e punëve ose shërbimeve në favor të shoqërisë. Vendimi i rritjes së kapitalit duhet të përcaktojë mënyrat e dhënies: në mungesë të çdo udhëzimi kontributi duhet të bëhet në para.

Në rast caktimi veprash ose shërbimesh ëshë e nevojshme një policë sigurimesh ose një dorëzani bankare dhe kjo për të garantuar, për vlerën e plotë që iu është dhënë atyre, detyrimet e marra përsipër nga ortaku që ka si objekt ofrimin e veprave ose të shërbimeve. Në këtë rast polica ose dorëzania mund të zëvendësohen nga ortaku me derdhjen e titullit të garancisë së shumës përkatëse në para pranë shoqërisë.

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



ENGLANTINA PATA  
Traduttore Giurato/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 69507  
eglapata@gmail.com

## Neni 6

Kapitali mund tē reduktohet nē rastet dhe sipas mënyrave tē parashikuara nga ligji nēpermjet vendimit tē Asamblesë së ortakëve, që duhet aplikuar me mazhorancat e parashikuara pēr ndryshimin e këtij Statuti, me pērjashtim tē sa pērcaktohet nga nenii vijues 36.

Nē rast reduktimi tē kapitalit nga humbjet, mund tē eleminohet depozitimi paraprak pranë selisë së shoqërisë, i relacionit tē organit administrativ mbi gjendjen pasurore tē shoqërisë dhe i vërejtjeve tē Organit tē Kontrollit ose tē Revizorit, nëse janë emëruar.

## Neni 7

Ortakët mund tē kryejnë, me kërkesë tē organit administrativ dhe sipas dispozitave fiskale nē fuqi, derdhje nē llogari/kapital ose financime pa interesa që nuk pērbëjnë mbledhje kursimesh mes publikut sipas dispozitave ligjore nē fuqi nē fushën bankare dhe kredituese.

Nē rast derdhjesh nē llogarinë kapitale, shumat pērkatëse mund tē pērdoren pēr mbulimin e humbjeve tē mundshme ose tē transferohen pēr rritje tē drejtpërdrejtë tē kapitalit tē çdo shume, dhe kjo pas vendimit pērkatës tē asamblesë.

Pēr rimbursimin e financimeve tē ortakëve gjen zbatim dispozita e nenit 2467 kodi civil.

## PJESËMARRJET – TRANSFERIMI I PJESËMARRJEVE

### Neni 8

Pjesëmarrja e çdo ortaku nuk mund tē jetë më e vogël se një euro ose se shumëfishë tē euros.

Lejohet caktimi i pjesëmarrjeve edhe nē masën që nuk është nē pērpjesëtim me kontributet.

**Të drejtat nē shoqëri** u takojnë ortakëve nē masën që është nē pērpjesëtim me pjesëmarrjen që zoteron secili prej tyre.

### Neni 9

Pjesëmarrjet janë tē transferueshme me akt mes personave që janë nē jetë. Nē rast transferimi me detyrim ortakëve tē tjerë u takon e drejta e përparësisë pēr blerjen.

Ortaku që do tē transferojë tërësisht ose pjesërisht pjesëmarrjen e tij duhet tē komunikojë kushtet e shitjes dhe emrin e blerësit me letër rekomande që duhet t'i dërgohet Organit Administrativ që duhet t'u dërgohet gjithë ortakëve tē cilët mund tē ushtrojnë tē drejtën e parablerjes brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e komunikimit. Nëse disa ortakë do tē donin tē ushtronin këtë tē drejtë, kuotat do tē caktohen nē pērpjesëtim me pjesëmarrjet nē fitime.

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



ENGLANTINA PATA  
Tradutore Gjuralo/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 69507  
eglapata@gmail.com

Nëse asnje ortak nuk do të ushtojë të drejtën e parablerjes brenda afatit të mësipërm kuotat mund t'u transferohen të tretëve.

Në gjithë rastet kur pagesa nuk është me para, çmimi i cedimit do të përcaktohet nga palët në marrëveshje mes tyre. Nëse nuk do të jetë arritur asnje marrëveshje, çmimi do të përcaktohet, nëpërmjet një relacioni të hartuar nga një ekspert i caktuar nga Kryetari i Gjykatës me kërkesë të palës më të përfshirë.

E drejta e parablerjes u takon ortakëve edhe kur do të transferohet pronësia e zhveshur e pjesëmarrjes. E drejta e parablerjes nuk vlen përrastin e lënies peng ose uzufruktit.

E drejta e parablerjes u takon ortakëve edhe në rast transferimi të së drejtës së alternativës të treguar te pika e mësipërmë 5.

Në rast transferimi me akt mes personave në jetë kryer pa respektuar sa më sipër, blerësi nuk do të legitimohet për ushtrimin e votës dhe të të drejtave të tjera administrative dhe pasurore dhe nuk mund të tjetërsojë pjesëmarjen me efekt kundrejt shoqërisë.

Nuk u takon ortakëve e drejta e parablerjes, në rastin kur kalimi i pjesëmarrjeve ose e drejta e opzionit do të bëhet në favor të bashkëshortit të një ortaku ose të afërmë pasardhës të një ortaku, të çdo rradhe, ose shoqërive të kontrolluara ose kontrolluese ose pjesëmarrëse nga shoqëritë ortake.

#### **Neni 10**

Në rast vdekjeje të një prej ortakëve, të tjerët duhet të vendosin nëse të likuidojnë kuotën e trashëgimtarëve ose të vazhdojnë shoqërinë me vetë trashëgimtarët ose të shkrijnë shoqërinë.

Në rast likuidimi, trashëgimtarët do të kenë të drejtën e rimbursimit të pjesëmarrjes së ortakut që ka ndërruar jetë në përpjesëtim me pasurinë e shoqërisë.

Vendimet do të merren nga ortakët, në zbatim të nenit vijues 12, pa mbajtur parasysh, me qëllim përllogaritjen e mazhorancës, pjesëmarjen e ortakut që ka ndërruar jetë.

Në rast vazhdimësie të shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka ndërruar jetë, ata duhet të zgjedhin një përfaqësues të përbashkët.

#### **VENDIMET E ORTAKËVE**

#### **Neni 11**

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



**Ortakët vendosin për çështjet që kanë në kompetencë të tyre nga ligji dhe nga ky Statut, si edhe për çështje që një ose disa administratorë ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën një të trejën e kapitalit të shoqërisë ua shtrojnë atyre për miratim.**

Në çdo rast mbeten në kompetencë të ortakëve:

- a) Miratimi i bilancit dhe shpërndarja e fitimeve;
- b) Zgjedhja e organit administrative;
- c) Emërimi në rastet e parashikuara nga ligji i Kontrollorëve dhe Kryetarit të Bordit të Kontrollit ose Revizorit;
- d) Ndryshimet e këtij Statuti;
- e) Vendimi për të kryer veprime që përbëjnë një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë ose një ndryshim domethënës të të drejtave të ortakëve.

Në lidhje me menaxhimin e shoqërisë u takojnë ortakëve kompetencat e përcaktuara në nenet vijuese 22 dhe 23.

Ndërsa siç parashikohet nga neni 2465 paragrafi i dytë kodi civil, nuk duhet autorizuar nga ortakët blerja nga ana e shoqërisë, për një shifër të barabartë ose më të madhe se e dhjeta e kapitalit të shoqërisë, e të mirave ose kreditimeve të ortakëve themelues, të ortakëve ose administratorëve, gjatë dy viteve nga regjistrimi i shoqërisë në regjistrin tregtar.

#### **Neni 12**

Vendimet e ortakëve, me përashtim të sa parashikohet nga neni i mëposhtëm. 13, paragrafi i parë, miratohen nëpërmjet konsultimit me shkrim, ose në bazë të miratimit shprehur me shkrim. Nëse do të zgjidhet sistemi i konsultimit me shkrim, duhet të hartohej një dokument i posaçëm me shkrim, ku duhet specifikuar qartazi:

- çështja objekt i vendimit;
- përbajtja dhe rezultatet e vendimit dhe si edhe autorizimet e mundshme që pasojnë atë;
- referimi i çdo opinioni të mundshëm të Bordit të Kontrollit, nëse emërohet (opinion që duhet t'i bashkëngjitet dokumentit në mënyrë që ortakët të njihen më të);
- specifikimi i ortakëve që kanë dhënë miratimin;
- specifikimi i ortakëve që janë kundër ose abstenojnë;
- nënshkrimi i gjithë ortakëve.

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



**ENGLANTINA PATA**  
Traditore Gjuralo/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 69507  
eglapata@gmail.com

Në vend të hartimit të një dokumenti të posaçëm autonom, vendimi me specifikimet dhe nënshkrimet përkatëse, mund të shkruhet drejtpërsëdrejti në Librin e Vendimeve të Ortakëve.

Nëse zgjidhet sistemi i **miratimit të shprehur me shkrim**, duhet të hartohet një dokument i posaçëm i shkruar nga i cili duhet të rezultojë qartazi:

- përbajtja objekti i vendimit;
- përbajtja dhe rezultatet e vendimit dhe miratimet e mundshme që rrjedhin prej saj;
- referimin e çdo opinioni të mundshëm të Bordit të Kontrollit, nëse emërohet (opinion që duhet t'i bashkëngjitet dokumentit në mënyrë që ortakët të njihen më të);

Një kopje e këtij dokumenti duhet t'i përcillet të gjithë ortakëve të cilët, brenda pesë ditëve duhet t'i dërgojnë shoqërisë një deklaratë të posaçme, të shkruar në fund të kopjes së dokumentit të marrë, në të cilin ata do të duhet të shprehin votën e tyre pro ose kundër, ose abstinen. Mungesa e deklarimit të ortakëve brenda afatit të sipërpërmendur është e barabartë me një votë kundër.

Dërgimet e parashikuara në këtë paragraf mund të bëhen me çdo mjet dhe/ose sistem komunikimi që lejon një konfirmim të dërgesës dhe marrjes, duke përfshirë faksin dhe postën elektronike. Për këto të fundit dërgimet duhet t'u bëhen ortakëve në numrin e faksit dhe/ose adresës së postës elektronike që janë komunikuar shprehimisht nga vetë ortakët.

Vendimet e anëtarëve merren me votën e favorshme të anëtarëve që përfaqësojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të shoqërisë.

Vendimi i ortakëve, i marrë në bazë të këtij nenit, duhet të shkruhet, pa vonesë, nga organi administrativ, në *Librin e vendimeve të ortakëve*. Përputhshmëria e transkriptimit me vendimin e marrë duhet të kontrollohet nga një Administrator dhe nga të paktën një ortak, që për këtë arsy do të nënshkruajnë në fund të këtij transkriptimi. Dokumentacioni përkatës, në original, duhet të mbahet te registrat e kompanisë.

Anëtarët kanë të drejtë të njihen me, konsultojnë dhe kontrollojnë në çdo moment *Librin e Vendimeve të ortakëve*.

## ASAMBLEJA

### Neni 13

Duke iu referuar çështjeve të treguara në pikën e mësipërme Neni 11, në pikat d) dhe e) në gjithë rastet e tjera shprehimisht të parashikuara nga Ligji ose nga ky Statut, ose kur e kërkojnë një ose disa administratorë ose një numër ortakësh që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata

**ENGLANTINA PATA**  
Tradutore/Gjurato/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 69507  
eglapata@gmail.com

shoqërisë, vendimet e ortakëve duhet të aplikohen nëpërmjet vendimit të asamblesë sipas metodës kolegjiale.

Për këtë qëllim mbledhja e asamblesë duhet të thirret nga Organi Administrativ edhe jashtë të selisë së shoqërisë mjaft që të jetë në Itali.

Asambleja **thirret** me njoftim të dërguar të paktën tetë ditë para datës së caktuar për mbledhjen, me letër rekomande ose me çdo mjet tjeter të përshtatshëm për këtë qëllim, dërguar ortakëve në adresën që rezulton nga Regjistri tregtar.

Në njoftimin e thirrjes së mbledhjes duhet të tregohen dita, vendi, ora e mbledhjes dhe lista e çështjeve që do të trajtohen.

Në njoftimin e thirrjes së mbledhjes së asamblesë duhet parashikuar një datë tjeter për një mbledhje të dytë në rast se në mbledhjen e parashikuar në thirrjen e parë rezulton që Asambleja nuk është mbledhur ligjërisht; megjithatë edhe gjatë thirrjes së dytë vlejnë të njëjtat mazhoranca si për thirrjen e parë.

Nëse në njoftim nuk është shënuar data e thirrjes së dytë, asambleja duhet të thirret përsëri brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e thirrjes së mbledhjes së parë.

Në mungesë të një thirrjeje formale, asambleja konsiderohet e krijuar siç duhet në formë totalitare kur në të merr pjesë i gjithë kapitali i shoqërisë, dhe të gjithë Administratorët dhe auditorët ligjorë janë të pranishëm ose të informuar dhe askush nuk e kundërshton trajtimin e çështjes. Nëse administratorët ose auditorët nuk marrin pjesë personalisht në asamble, duhet të lëshojnë një deklaratë të posaçme me shkrim, që duhet ruajtur në regjistrat e shoqërisë, në të cilën të deklarojnë se janë të informuar për të gjitha çështjet e rendit të ditës dhe se nuk janë kundër shqyrtimit të këtyre çështjeve.

#### Neni 14

Asambleja kryesoitet nga Administratori i Vetëm, nga Kryetari i Bordit Drejtues ose nga Administratori më i vjetër. Në rast mungese ose pamundësie të tyre, Asambleja do të drejtohet nga personi i zgjedhur me votim nga shumica e të pranishmëve.

Asambleja zgjedh, gjithmonë me votën e shumicës së të pranishmëve, një sekretar edhe jo ortakë dhe nëse është e nevojshme një ose më shumë kontrollues edhe jo ortakë.

I takon kryetarit të Asamblesë që të konstatojë përbërjen e rrugës së saj, të verifikojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të drejtojë dhe rrugullojë përbajtjen e asamblesë dhe të verifikojë rezultatet e votimeve.

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



Eshtë e mundur mbajtja e mbledhjeve të Asamblesë me pjesëmarrës të vendosur në vende të ndryshme, afër ose larg njëri tjetrit, të lidhura me audio/video dhe kjo në kushtet e mëposhtme, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalet përkatëse:

- të jenë të pranishëm në të njëtin vend Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes të cilët do të sigurojnë hartimin dhe nënshkrimin e procesverbalit;
- t'i mundësohet Kryetarit të asamblesë verifikimi i identitetit dhë legjitimitetit të pjesëmarrësve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe shpallë rezultatet e votimit;
- që subjekti hartues i procesverbalit të jetë në gjendje të perceptojë në mënyrën e duhur ngjarjet e asamblesë që janë objekt i hartimit të procesverbalit;
- që pjesëmarrësit të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, si dhe për t'u njojur, marrë ose dërguar dokumente;
- të tregohen në njostimin e thirrjes (përveç rastit të asamblesë totalitare) vendet e lidhura nga shoqëria me audio/video në të cilat pjesëmarrësit do të mund të marrin pjesë, pasi takimi duhet të konsiderohet i mbajtur në vendin ku do të jenë të pranishëm Kryetari dhe hartuesi i procesverbalit. Gjithashtu duhet të përgatiten aq fletë pjesëmarrjeje sa numri i vendeve të lidhura me audio/video ku mbahet takimi.

#### Neni 15

Vota e çdo ortaku **është në përpjesëtim me pjesëmarrjet e tij.**

Kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhje ortakët që në datën e mbajtjes së asamblesë janë regjistruar në Regjistrin Tregtar.

Çdo ortak që ka të drejtë të marrë pjesë në asamble mund të përfaqësohet me delegim me shkrim, delegim që duhet të mbahet nga shoqëria.


Pranohet edhe prokura e përgjithshme që të jetë e vlefshme për më shumë se një mbledhje të asamblesë, pavarësisht nga rendi i tyre i ditës.

Përfaqësimi nuk mund t'u jebet as administratorëve, as audituesve (ose revizorit) nëse janë emëruar dhe as punonjësve të shoqërisë dhe as shoqërive të kontrolluara prej saj ose anëtarëve të organeve administrative ose të kontrollit ose punonjësve të tyre.

Asambleja quhet e mbledhur në mënyrë të rregullt nëse janë të pranishëm aq ortakë sa përfaqësijnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të shoqërisë.

Asambleja e thirrur në mënyrën e duhur, siç përcaktohet te paragrafi paraardhës, vendos me mazhorancën absolute të të pranishmëve, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga nen i mëparshëm 14 pika d) dhe e) në të cilat vendos me mazhorancë absolute të të pranishmëve, por

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



ENGLANTINA PATA  
Tradutore Giurato/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 69507  
eglapata@gmail.com

gjithsesi me votë në favor të një mazhorance që përfaqëson të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë.

Mbeten, megjithatë, të pandryshuara dispozitat e tjera të këtij statuti që për vendime të veçanta kërkojnë shumica të ndryshme specifike.

#### Neni 16

Vendimet e Asamblesë duhet të pasqyrohen te procesverbali i nënshkruar nga Kryetari ose nga Sekretari ose nga Noteri nëse kërcohët nga Ligji.

Procesverbali duhet të hartohet pa vonesa brenda afateve të nevojshme për zbatimin në kohë të detyrimeve për depozitimin dhe publikimin.

#### ADMINISTRIMI

#### Neni 17

Shoqëria mund të administrohet në mënyrë të alternuar:

a) Nga një Administrator i Vetëm

b) nga një **Bord Drejtues**, që përbëhet minimalisht nga dy ose maksimumi nga pesë anëtarë;

Administratorët mund të janë edhe jo ortakë dhe janë të rizgjedhshëm.

#### Neni 18

Administratorët do të qëndrojnë në detyrë derisa të shkarkohen ose të jepin dorëheqjen ose për një afat kohor më të kufizuar që do të vendoset nga ortakët gjatë emërimit të tyre.

Në rast se është emëruar Bordi Drejtues, nëse për çfarëdo arsyet nuk realizohet shumica e Këshilltarëve, bie i gjithë Bordi Drejtues.

Bordi i revokuar do të jetë në gjendje të kryejë vetëm aktet e administrimit të zakonshëm.

Largimi i administratorëve për shkak të skadimit të afatit hyn në fuqi që nga momenti në të cilin krijohet organi i ri administrativ.

#### Neni 19

Nëse kompania administrohet nga një Bord Drejtues, ai zgjedh një kryetar nga radhët e anëtarëve të tij, nëse ai nuk është zgjedhur nga ortakët gjatë emërimit, dhe me gjasa edhe një Zëvendës Kryetar për ta zëvendësuar Kryetarin në rast mungese ose pamundësie, dhe një ose më shumë Administratorë të Deleguar duke përcaktuar kompetencat e tyre.

#### Neni 20

Nëse kompania menaxhohet nga një **Bord Drejtues**, **vendimet** e tij, me përashtim të sa parashikohet në nenin vijues 21, zbatohen nëpërmjet konsultimit me shkrim ose sipas miratimit të shprehur me shkrim.

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata

ENGLANTINA PATA  
Tradutore Giurato/Përkthyes Zyrtar  
Tel: +355 (0) 88 29 69507  
eglapata@gmail.com

Nëse zgjidhet sistemi i miratimit të shprehur me shkrim, duhet të hartohet një dokument i posaçëm i shkruar nga i cili duhet të rezultojë qartazi:

- përbajtja objekti i vendimit;
- përbajtja dhe rezultatet e vendimit dhe miratimet e mundshme që rrjedhin prej tij;
- referimin e çdo opinioni të mundshëm të Bordit të Kontrollit, nëse emërohet (opinion që duhet t'i bashkëngjitet dokumentit në mënyrë që ortakët të njihen më të);
- specifikimin e ortakëve që kanë dhënë miratimin;
- specifikimin e ortakëve që janë kundër ose abstenojnë;
- nënshkrimin e të gjithë ortakëve.

Në vend të hartimit të një dokumenti të posaçëm autonom, vendimi me referimet dhe nënshkrimet përkatëse, mund të shkruhet drejtpërsëdrejti në *Librin e Vendimeve të Administratorëve*.

Nëse zgjidhet sistemi i **miratimit të shprehur me shkrim**, duhet të hartohet një dokument i posaçëm i shkruar nga i cili duhet të rezultojë qartazi:

- përbajtja objekti i vendimit;
- përbajtja dhe rezultatet e vendimit dhe miratimet e mundshme që rrjedhin prej tij;
- referimin e çdo opinioni të mundshëm të Bordit të Kontrollit, nëse emërohet (opinion që duhet t'i bashkëngjitet dokumentit në mënyrë që ortakët të njihen më të);

Një kopje e këtij dokumenti duhet t'i përcillet të gjithë ortakëve të cilët, brenda pesë ditëve duhet t'i dërgojnë shoqërisë një deklaratë të posaçme, të shkruar në fund të kopjes së dokumentit të marrë, në të cilin ata do të duhet të shprehin votën e tyre pro ose kundër, ose abstenim. Mungesa e deklarimit të ortakëve brenda afatit të sipërpërmendur është e barabartë me një votë kundër.

Dërgimet e parashikuara në këtë paragraf mund të bëhen me çdo mjet dhe/ose sistem komunikimi që lejon një konfirmim të dërgesës dhe marrjes, duke përfshirë faksin dhe postën elektronike.

Vendimet e Bordit Drejtues merren nëpërmjet votës së favorshme të shumicës së Administratorëve në detyrë.

Vendimi i administratorëve, zbatuar sipas këtij nenit duhet të pasqyrohet nga organi administrativ në Librin e Vendimeve të Administratorëve. Dokumentacioni përkatës, në original, do të ruhet në aktet e shoqërisë.

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



ENGLANTINA PATA  
Tradutore Giurato/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 89507  
eglapata@gmail.com

Me mazhorancën e përcaktuar në këtë nen, Administratorët mund të vodosin të bazojnë vendimin në argumente të veçanta ose mbi vepime specifike me vendim të Bordit Drejtues që duhet zbatuar sipas mënyrës kolegiale.

### Neni 21

Duke iu referuar çështjeve të treguara nga Neni 2475 paragrafi i pestë i kod civil ose në rastin e treguar në ninin e mëparshëm 20, paragrafi i fundit, ose në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj ose me këtë statut, vendimet e Bordit Drejtues duhet të miratohen me vendim kolegjal.

Për këtë qëllim, Bordi Drejtues:

- thirret nga Kryetari me njostim të dërguar me letër rekomande, ose me çdo mjet tjeter të përshtatshëm për qëllimin (për shembull faks, postë elektronike), të paktën tre ditë para mbledhjes dhe në raste urgjente me telegram që duhet të dërgohet të paktën një ditë më parë, në të cilin shënohet data, vendi dhe orën e mbledhjes si dhe rendi i ditës;
- mblidhet në selinë e shoqërisë ose diku tjeter, mjaft që të jetë në Itali.

Mbledhjet e Bordit dhe vendimet e tij janë të vlefshme edhe pa thirrjen formale, kur janë të pranishëm të gjithë Këshilltarët në detyrë në detyrë dhe auditorët nëse janë emëruar.

Eshtë e mundur mbajtja e mbledhjeve të Bordit Drejtues me pjesëmarrës të vendosur në vende të ndryshme, të lidhura me audio/video dhe kjo në kushtet e mëposhtme, të cilat duhet të pasqyrohen në procesverbalet përkatëse:

- të janë të pranishëm në të njëtin vend Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes të cilët do të merren me hartimin dhe nënshkrimin e procesverbalit pasi mbledhja do të konsiderohet e mbajtur në këtë vend;
- që Kryetari i asamblesë të mund të verifikojë identitetin dhe legjimititetin e pjesëmarrësve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe shpallë rezultatet e votimit;
- që subjekti hartues i procesverbalit të jetë në gjendje të perceptojë në mënyrën e duhur ngjarjet e asamblesë që janë objekt i hartimit të procesverbalit;
- që pjesëmarrësit të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, si dhe për t'u njohur, marrë ose dërguar dokumente;

Bordi Drejtues vendos në mënyrë të vlefshme, në formë kolegiale, në praninë efektive të shumicës së anëtarëve të tij në detyrë dhe me shumicë votash absolute të të pranishmëve. Në rast barazimi, propozimi nuk pranohet. Vota nuk mund të jezet për përfaqësim.

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



ENGLANTINA PATA  
Tradutore Giurato/Përkthyes Zyrtar  
Cel. +355 (0) 68 29 69507  
eglapata@gmail.com

Vendimet e Bordit Drejtues tē miratuara nē bazē tē kësaj nenii verifikohen me procesverbal tē nënshkruar nga kryetari dhe sekretari. Ky procesverbal, edhe nēse është përpiluar më akt publik, duhet tē transkriptohet nē *Librin e Vendimeve tē Administratorëve*.

Vendimet e Bordit Drejtues pér çështjet e rezervuara nē kompetencë tē tij nē përputhje me nenin e mëposhtëm 36 duhet tē zbatohen me vendim kolegjial nē bazē tē këtij nenii, siç do tē konstatohet nëpërmjet procesverbalit tē hartuar nga Noteri me akt publik.

### Neni 22

Menaxhimi i shoqërisë i besohet **organit administrativ**. Pér këtë qëllim organi mund tē kryejë gjithë aktet dhe gjithë veprimet që kërkojnë administrim tē zakonshëm dhe jashtëzakonshëm, me përjashtim vetëm tē atyre akteve dhe veprimeve që ligji dhe ky statut ia rezervojnë shprehimisht ortakëve.

Në veçanti, i rezervohet **asamblesë së ortakëve** vendimi pér tē kryer veprime që përbëjnë një ndryshim thelbësor tē objektit tē shoqërisë osë një ndryshim tē konsiderueshëm tē tē drejtave tē ortakëve.

### Neni 23

Administratorët kanë përfaqësimin e përgjithshëm tē shoqërisë.

Në rast tē emërimit të Bordit Drejtues, përfaqësimi i shoqërisë do i takojë gjithë anëtarëve tē Bordit Drejtues veçmas nga njëri-tjetri.

Emërimi i drejtorëve, drejtuesve dhe përfaqësuesve tē posaçëm i takon Organit Administrativ.

Përfaqësimi i shoqërisë i takon gjithashtu drejtorëve, drejtuesve ose përfaqësuesve nē kufijtë e kompetencave tē përcaktuara nē aktin e emërimit.

### Neni 24

Administratorëve, përvëç rimbursimit tē shpenzimeve tē bëra pér ushtrimin e funksioneve tē tyre, mund t'u caktohet një dëmshpérblim total vjetor, edhe nē formën e pjesëmarrjes nē fitime, që do tē përcaktohet nga ortakët gjatë emërimit ose me vendim tē posaçëm.

Nëse shoqëria administrohet nga një Bord Drejtues, shpérblimi i administratorëve që mbulojnë funksione tē veçanta përcaktohet nga vetë bordi, pasi ka marrë mendimin e Bordit tē Audituesve Ligjorë, nëse është emëruar.

Organit Administrativ mund t'i atribuohet gjithashtu edhe e drejta e përfitimit tē një dëmshpérblimi pér mbylljen e marrëdhënies së bashkëpunimit tē koordinuar dhe tē vazhdueshëm nëpërmjet rezervave vjetore ose nëpërmjet një police sigurimi tē posaçme.

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



## ORGANI I KONTROLLIT

### Neni 25

Pas verifikimit të kushteve të ligjit apo me vullnetin e asamblesë së ortakëve do të procedohet me emërimin, nga kjo e fundit, me zgejdhje të sa, në mënyrë alternative e një Auditori ose të një Organi mbikëqyrës (monokratik ose kolegjal), i cili do të qëndrojë në detyrë për tre vite financiare dhe do të përfundojë detyrën në datën e asamblesë së thirrur për të miratuar bilancin e vitit të tretë ushtrimor në detyrë. Nëse nuk përcaktohet ndryshe nga asambleja e ortakëve, e cila në këtë rast do të emërojë një Revizor ligor të llogarive ose një shoqëri auditimi e regjistruar në Regjistrin përkatës, auditimi ligor i llogarive është përgjegjësi e Organit të kontrollit sido që të jetë i përbërë.

Asambleja, para se të vazhdojë me emërimin, do të përcaktojë përbërjen e Bordit të kontrollit, monokratik (Auditori i vetëm) ose kolegjal (Bordi i Audituesve), i cili në këtë rast të fundit do të përbëhet nga tre anëtarë efektivë dhe dy anëtarë zëvendësues.

Asambleja do të procedojë me zgjedhjen e Auditorit apo Organit Mbikëqyrës (në këtë rast monokratik ose kolegjal).

Në momentin e emërimit, Asambleja do të përcaktojë shpërblimin që i takon Organit të kontrollit.

## TËRHEQJA DHE PËRJASHTIMI I ORTAKUT

### Neni 26

E drejta e tërheqjes ushtrohet në të gjitha rastet e parashikuara nga ligji ose nga ky Statut.


Synimi i ortakut për të ushtruar të drejtën e tërheqjes duhet t'i komunikohet Organit Administrativ me letër rekomande me vërtetim pranimi brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga regjistrimi në Regjistrin e Shoqërive të vendimit që legitimoni të drejtën e tërheqjes; nëse fakti që legitimoni tërheqjen është i ndryshëm nga një vendim që duhet regjistruar në Regjistrin tregtar, ai ushtrohet brenda tridhjetë ditëve nga njohja e tij nga ortaku. Pjesëmarjet për të cilat ushtrohet e drejta e tërheqjes nuk mund të edohen. Tërheqja nuk mund të ushtrohet dhe, nëse është ushtruar, është e paefektshme, nëse shoqëria e revokon vendimin dhe/ose vendimi që e legitimoni atë, ose nëse mbledhja e ortakëve vendos shpërbërjen e shoqërisë.

Ortakët që tërhiqen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin rimbursimin e pjesëmarries së tyre, në bazë të nenit 2473 të Kodit Civil.

### Neni 27

**Përjashtohet ortaku** që nuk ka dhënë kontribute brenda afateve të përcaktuara, nëse nuk ka qenë e mundur të procedohet me shitjen e kuotës së tij dhe kjo në zbatim dhe përfshirë të nenit 2466 të kodit civil. Në rastin e një ortaku i cili si kontribut është i detyruar të ofrojë punë ose

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



shërbime në favor të shoqërisë, ai mund të përjashtohet nëse nuk është më në gjendje të ofrojë punën ose shërbimet objekt të kontributit.

Mund të përjashtohet edhe një ortak i përjashtuar, që është deklaruar i falimentuar ose që është dënuar me vendim të formës së prerë me një dënim i cili përfshin edhe përjashtimin e përkohshëm nga mbajtja e funksioneve publike.

Përjashtimi duhet të miratohet nga mbledhja e ortakëve me një vendim të posaçëm që duhet aplikuar në zbatim të neneve të mësipërme 13 e në vijim. Për krijimin e vlefshëm të asamblesë dhe për llogaritjen e shumicës së kërkuar nuk merret parasysh pjesëmarrja e ortakut të përjashtuar, të cilat nuk i takon as e drejta e ndërrhyrjes në asamble.

Vendimi i përjashtimit duhet t'i njoftohet ortakut të përjashtuar dhe përjashtimi do të ketë efekt pas tridhjetë ditësh nga njoftimi i sipërpërmendorur.

Brenda këtij afati, ortaku i përjashtuar mund të paraqesë ankirim pranë Gjykatës kompetente për zonën. Paraqitura e ankimit pezullon efektet e vendimit të përjashtimit. Nëse shoqëria përbëhet nga vetëm dy ortakë, përjashtimi i njërit prej tyre shpallet nga Gjykata, me kërkësë të tjeterit.

Ortaku i përjashtuar ka të drejtën e likuidimit të pjesëmarrjeve të tij.

## BILANCI DHE DESTINACIONI I FITIMEVE

### Neni 28

**Vitet financiare** mbyllen më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

Në mbyllje të çdo viti financiar, organi administrativ parashikon përpilimin e bilancit ushtrimor dhe formaliteteve pasuese në përputhje me ligjet në fuqi.

Bilanci duhet të miratohet nga ortakët, me vendim që do të miratohet në bazë të nenit të mëparshëm 12, brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit financiar, ose brenda njëqind e tetëdhjetë ditësh nëse e kërkojnë nevoja të veçanta në lidhje me strukturën dhe objektin e shoqërisë. Në këtë rast, administratorët duhet të raportojnë në raportin e tyre të menaxhimit (ose në shkresën plotësuese të bilancit të hartuar në formë të shkurtuar) arsyet e zgjatjes së afatit.

### Neni 29


Nga **fitimet neto** që rezultojnë nga bilanci duhet të zbritet një shumë që përkon me 5% (pesë për qind) që do të shërbejë si rezervë ligjore derisa kjo e fundit të ketë arritur një të pestën e kapitalit të shoqërisë.

Vendimi i ortakëve për miratimin e bilancit vendos për shpërndarjen e fitimeve ortakëve.

## SHKRIRJA DHE LIKUIDIMI

### Neni 30

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



**ENGLANTINA PATA**  
Tradutore Giurato/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 69507  
eglapata@gmail.com

**Shkrirja e parakohshme vullnetare** e shoqërisë vendoset nga Asambleja e ortakëve, me shumicën e parashikuar për ndryshimin e këtij Statuti. Në rastin e përmendor në paragrafin e mëparshëm si dhe në rast të shkaqeve të tjera të shpërbërjes parashikuar nga neni 2484 i kodit civil ose nga dispozita të tjera të ligjit ose të këtij Statuti, Asambleja me një vendim të posaçëm që do të zbatohet gjithmonë me shumicë të parashikuar për ndryshimin e këtij Statuti, përcakton:

- numrin e likuiduesve dhe rregullat e funksionimit të bordit në rast shumësie të likuiduesve;
- emërimin e likuiduesve, duke evidentuar ata të cilëve u takon përfaqësimi i shoqërisë;
- kriteret mbi bazën e të cilave duhet të bëhet likuidimi;
- kompetencat e likuiduesve.

Në mungesë të ndonjë dispozite në lidhje me kompetencat e likuiduesve, aplikohet dispozita e nenit 2489 i kodit civil

Shoqëria mund **të revokojë në çdo kohë gjendjen e likuidimit**, duke eleminuar më parë shkakun e shpërbërjes, me vendim të asamblesë marrë me shumicën e kërkuar për ndryshimet e këtij Statuti. Ortaku që nuk ka marrë pjesë në vendimet në lidhje me revokimin e gjendjes së likuidimit gjëzon të drejtën e tërheqjes.

Për efektet e revokimit zbatohet neni 2487 ter kodi civil.

## TITUJ TË DEBISË

### Neni 31

Shoqëria mund të emetojë **tituj debie** bartësit ose personave.

Emetimi i tituve të debisë vendoset nga organi administrativ ose nga asambleja e ortakëve (kjo e fundit me shumicën e parashikuar për ndryshimin e këtij Statuti) sipas dispozitave të nenit të mëposhtëm 36.

Shoqëria mund të emetojë tituj debie për shumën totale që nuk tejkalon kapitalin e shoqërisë, rezervën ligjore dhe rezervat e disponueshme që rezultojnë nga bilanci i fundit i miratuar.

Vendimi për emetimin e tituve duhet të parashikojë kushtet e huasë dhe mënyrat e rimbursimit dhe duhet të regjistrohet nga administratorët në Regjistrin Tregtar. Mund të parashikojë gjithashu që, me miratim të shumicës së zotëruesve të letrave me vlerë, shoqëria mund t'i ndryshojë këto kushte e mënyra.

Zotëruesit e tituve zbatojnë vendimet e tyre me shumicë absolute, të llogaritur në bazë të vlerës nominale të vetë tituve, në çfarëdo forme, mjëft që të garantohet pjesëmarra në vendimin e të gjithë zotëruesve të tituve dhe vendimi përfundimtar të pasqyrohet në një dokument të shkruar. Në veçanti, zotëruesit e tituve mund të marrin vendime në lidhje me:

- emërimin dhe revokimin e një përfaqësuesi të përbashkët që duhet të ekzekutojë vendimet e vetë zotëruesve dhe të mbrojë interesat e përbashkëta në marrëdhëni e shoqërisë;
- ndryshime në kushtet e huasë;

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



- krijimin e një fondi për shpenzimet e nevojshme për mbrojtjen e interesave të përbashkëta dhe reportin përkatës;
- për çështje të tjera me interes të përbashkët

## KLAUZOLA E ARBITRAZHIT

### Neni 32

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis ortakëve ose midis ortakëve dhe shoqërisë, edhe nëse është promovuar nga administratorët, likuiduesit dhe auditorët ligjorë (nëse janë emëruar) ose ndaj vetë atyre dhe që kanë si objekt të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet në shoqëri, do të vendoset nga Bordi i Arbitrazhit, i përbërë nga tre anëtarë, të gjithë të emëruar, brenda tridhjetë ditëve nga kërkesa e bërë nga pala më e interesuar, nga Kryetari i Këshilli i Noterëve të rrethit në të cilin ndodhet selia e shoqërisë. Tre anëtarët e emëruar në këtë mënyrë do të zgjedhin Kryetarin. Në rast se emërimi nuk do të bëhet brend aafateve, ose në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet anëtarëve të caktuar në zgjedhjen e Kryetarit, do të veprojë, me kërkesë të palës më të interesuar, Kryetari i Gjykatës në rrethin e së cilës ndodhet selia e shoqërisë.

Kolegji i Arbitrazhit do të vendosë me shumicë votash brenda nëntëdhjetë ditëve nga themelimi i tij, në mënyrë të pakthyeshme për palët, si arbitër jo i ritit, përjashtuar nga çdo formalitet procedural dhe nga detyrimi për depozitim e vendimit kolegjal.

Gjejnë zbatim gjithsesi dispozitat sipas neneve 35 dhe 36 të Dekretit Legjislativ të datës 17 janar 2003, nr. 5.

Bordi i Arbitrazhit do të përcaktojë se në ngarkim të kujt do të jetë ose metodat e mundshme të ndarjes së kostos së arbitrazhit.

Mosmarrëveshjet në të cilat ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të Prokurorit nuk mund të jetë objekt kompromisi.

Ndryshimet në këtë klauzolë arbitrazhi duhet të miratohen me vendim të ortakëve me shumicën prej të paktën dy të tretave të kapitalit të shoqërisë. Ortakët që nuk janë të pranishëm ose që nuk japid miratimin brenda nëntëdhjetë ditëve në vijim, mund të ushtrojë të drejtën për t'u tërhequr

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 33

Adresa e ortakëve, në lidhje me shoqerinë ose mes tyre, është ajo që rezulton në Regjistrin tregtar.

### Neni 34

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



Nëse kompania menaxhohet nga një Bord Drejtues, mund të miratohen nga vetë Bordi, gjatë asamblesë së ortakëve, vendimet në lidhje me:

- rritjen e kapitalit brenda kufijve dhe në kushtet e përcaktuara në nenin e mëparshëm. 5; - adoptimin, në rast të zvogëlimit të kapitalit me më shumë se një të tretën si rezultat i humbjeve, e masave në zbatim të nenit. 2482 bis kodi civil; - miratimin e planit të bashkimit në rastet dhe kushtet e parashikuara sipas nenit 2505 dhe 2505 bis të kodit civil. - emetimi i titujve të debisë përmendur në nenin e mëparshëm 33. Aplikohet dispozita e përmendur në nenin e mëparshëm 21.

Nëse kompania menaxhohet nga një Administrator i Vetëm, vendimet në lidhje me çështjet e përmendura në paragrafin e mëparshëm u rezervohen ekskluzivisht Asamblesë së Ortakëve.

### **Neni 35**

Për sa nuk parashikohet në këtë Statut zbatohen dispozitat e ligjit në fushën e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Nënshkruar: Lucia Franchini

Nënshkruar: Gianantonio Barioni

Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



Kopje e njehsuar me originalin e firmosur sipas ligjit dhe depozituar në aktet e mia që lëshohet për përdorimet e lejuara nga ligji.

Zocca (MO) 5.7.2023



Përkthyes zyrtar: Englantina Pata



**APOSTILLE**  
**(Marrëveshja e Hagës datë 5 tetor 1961)**

1. Shteti: Republika e Italisë

Ky akt publik

2. Është nënshkruar nga: Gianantonio Barioni

3. Në cilësinë e: Noterit

4. Është i pajisur me vulën e: **Prokurorisë Modena**

**Vërtetuar**


5. Në: Modena      6. Më 7 korrik 2023

7. Nga: Prokurori Luca Masini

8. Me numër: **1118/23**

9. Pulla/Vula:

10. Firma: Prokuror  
Luca Masini  
(firmë)



Përkthyes zyrtar: Englantina Pata

**ENGLANTINA PATA**  
Tradutore Giurato/Përkthyes Zyrtar  
Cel: +355 (0) 68 29 69507  
eglapata@gmail.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**  
**NOTER GENTJANA A. DEDJA**



V2023051390283040905

DATE 20/07/2023  
NR REP 3435



**VËRTETIM PËRKTHIMI**

Sot, më datë 20/07/2023, para meje Notere GENTJANA A. DEDJA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën SKENDER LUARASI, NR.19, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYES:**

Englantina Pata, atësia Arqile, amësia Liljana, shtetase Shqiptare, lindur në Vlorë dhe banues në TIRANË, me adresë Nikolla Jorga; Nd. 14; H. 5; Ap. 3; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 25/04/1979, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037328928 dhe nr. personal H954252280 , .


Përkthyesja është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, ie cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

GENTJANA A. DEDJA



A/5  
Acquarone

**Dott. GIANANTONIO BARIONI**

**N O T A I O**

Via M. Tesi, 1109/E - 41059 Zocca (MO)

Tel. 059/987161 - Fax 059/9751108

Repertorio n. 9937

Raccolta n. 6787

-----  
----- **Verbale d'assemblea della** -----  
----- **"F&B DISTRIBUZIONE SRL"** -----  
----- **REPUBBLICA ITALIANA** -----  
L'anno duemila venti, il giorno undici del mese di novembre. -----  
----- 11/11/2020 -----

In Zocca (MO), nel mio studio in Via Mauro Tesi n. 1109/E, alle ore 10.30 (dieci e trenta).

Innanzi a me dott. Gianantonio Barioni, notaio in Zocca, iscritto al Collegio Notarile del Distretto di Modena, è presente la signora:

- Franchini Lucia, nata a Castel d'Aiano (BO) il giorno 15 marzo 1958, domiciliata per la carica presso la sede sociale, cittadina italiana, la quale dichiara di agire nel presente atto nella sua qualità di Amministratore Unico della "F&B DISTRIBUZIONE SRL", società a responsabilità limitata con unico socio, con sede legale in Vignola (MO), Via Giuseppe Soli n. 3, costituita in Italia, capitale sociale Euro 40.000,00 (quarantamila) interamente versato, Partita IVA, codice fiscale e numero d'iscrizione al Registro delle Imprese di Modena 03404970364, iscritta al R.E.A. presso la C.C.I.A.A. di Modena al n. 384881.

La comparente, della cui identità personale, qualifica e poteri io notaio sono certo, dichiara che oggi 11 novembre 2020 è riunita in questo luogo, giorno ed ora in forma totalitaria, a norma dell'art. 13 dello statuto sociale, l'Assemblea dei soci della società "F&B DISTRIBUZIONE SRL"; e mi invita a redigere il verbale dell'assemblea dei soci. Al che aderendo io notaio do atto di quanto segue. Assume la presidenza, a norma dell'art. 14 dello statuto sociale, la comparente la quale accerta e dichiara:

- che la presente assemblea non è stata convocata;
- che è presente l'unico socio signor Imperato Sergio, nato a Napoli il 13 dicembre 1969, titolare di una partecipazione di nominali Euro 40.000,00 (quarantamila) pari al 100% (cento per cento) del capitale sociale;
- che l'unico socio intervenuto rappresenta l'intero capitale sociale;
- che l'unico socio intervenuto, accertatane l'identità, è iscritto nel Registro delle Imprese ed è legittimato ad intervenire alla presente assemblea;
- che dell'organo amministrativo è presente la comparente, quale Amministratore Unico;
- che non è stato nominato l'Organo di controllo, in mancanza dei presupposti che rendano la nomina obbligatoria;
- che la presente assemblea, anche in mancanza di regolare convocazione, è validamente costituita in forma totalitaria, a norma dell'art. 13 dello statuto sociale e idonea a deliberare;
- che viene determinato il seguente

ORDINE DEL GIORNO:

1) Proposta di trasferimento della sede sociale da Vignola (MO), Via Giuseppe Soli n. 3 ad Anzola dell'Emilia (BO), Via Giovanni Amendola n. 2/1;

- che nessuno dei presenti si oppone alla trattazione degli argomenti sopra trascritti.

Prende la parola il Presidente e, in relazione all'unico argomento posto all'ordine del giorno sopra trascritto, espone all'assemblea le ragioni di carattere operativo per le quali si ritiene opportuno per la società trasferire la sede sociale da Vignola (MO), Via Giuseppe Soli n. 3 ad Anzola dell'Emilia (BO), Via Giovanni Amendola n. 2/1 e propone all'assemblea di deliberare in merito. Il Presidente accerta e mi dichiara che l'Assemblea della società, udita la sua relazione, con il voto favorevole dell'unico socio costituente la compagine sociale

delibera

- di trasferire la sede sociale da Vignola (MO), Via Giuseppe Soli n. 3 ad Anzola dell'Emilia (BO), Via Giovanni Amendola n. 2/1;

- di modificare in conseguenza l'articolo 2) del vigente statuto nel testo che qui di seguito si riporta:

----- Registrato presso

----- Agenzia delle Entrate

----- Ufficio di Modena

----- il 25/11/2020

----- Al n. 27680 Serie 1T


----- Esatte Euro 695,00

----- Iscritto nel Registro

----- delle Imprese di Bologna

----- In data 26/11/2020

----- n. protocollo 80468/2020



----- "Art. 2" -----

La società ha sede nel Comune di Anzola dell'Emilia (BO), all'indirizzo risultante dalla apposita iscrizione eseguita presso il Registro delle Imprese.

L'Organo Amministrativo ha facoltà di istituire e di sopprimere ovunque unita' locali operative (ad esempio succursali, filiali o uffici amministrativi senza stabile rappresentanza) ovvero di trasferire la sede sociale nell'ambito del Comune. Spetta invece ai soci deliberare la istituzione di sedi secondarie o il trasferimento della sede in Comune diverso."

